

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarene vetme gjykuese Lumnije Krasniqi, me zyrtarin ligjor Leutrim Hoti, në çështjen penale, kundër të pandehurit **P.M.**, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1, nën par.1.4, të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.6501/15, të dt.24.11.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrorit ndëshkimor PP.II.nr.6501/15, të dt.24.11.2017, më dt.**20.03.2018**, jashtë seancës gjyqësore, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.6501/15, të dt.24.11.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMORË

I pandehuri:P.M. nga i ati F., dhe e ëma M.1, e gjinisë M.2, i lindur me dt...., me vendbanim në Rr."R.G.", në P., me nr ID...., shqiptar, shtetasi Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

S e p s e:

Me dt. 03.09.2017, rreth orës 09:05, në Rr. "R.G.", në P., i pandehuri pas mosmarrëveshjes paraprake që kishte pasur me të dëmtuarin E.S., me dashje dhe me qëllim të shkakimit të lëndimit trupor, e kishte përdorur dhunën fizike ndaj tij, ashtu që të njëjtin e kishte goditur me grushte trupit, me ç'rast i njëjti kishte pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndet,-

- me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1, nën par. 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **300 (treqind euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, **me 3 (tri) këste mujore.**

Obligohet i pandehuri që t'i paguaj shpenzimet procedurale dhe atë në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej **20 €**, si dhe në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumë prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari E.S. me adresë banimi në fsh. A. e P., Komuna S., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.6501/15, të dt.24.11.2017, e ka akuzuar **P.M.-**, për shkak të veprës penale Lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.1, nën par.1.4 të KPRK-së dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimorë, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se ipandehuri, vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. V.H. dt. 09.11.2017, deklaratat e të dëmtuarit E.S., dhe dokumentacioni me shkresat e tjera të lëndës, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Në bazë të mendimit të ekspertit mjeko-ligjor Dr. V.H. dt. 09.11.2017, për të dëmtuarin, lidhur me natyrën dhe shkallën e lëndimeve trupore rezulton se i dëmtuari E.S. si pasojë e dhunës së ushtruar ka pësuar ndrydhje (mbretje) të indeve të buta me gjakderdhje nënllëkurore të regjionit muror të anës së majtë të kokës dhe të regjionit të shpatullave, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo të mprehtë, i topitur) dhe si të tilla, bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, është marr në bazë të nenit 450 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPP-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.5391/17, i dt.20.03.2018

Zyrtari Ligjor,

Gjyqtarja Leutrim Hoti
Lumnije Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.